

Nr. 5 Regj.

Durrës, më 30. 04. 2024

Lënda: Në përgjigje të kërkesës suaj.

Emër MBIEMËR

Në kuadër të implementimit të Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe në referencë të kërkesës suaj, datë 16.04.2024 me objekt “[Kërkesë për informacion mbi aktivitetin e hekurudhës](#)”, e regjistruar në regjistrin e “Kërkesë/Ankesë/Përgjigje” në përputhje me nenin 8 të ligjit të sipërcituar me nr. 5, ju informojmë sipas pyetieve të parashtruara për si vijon:

1-Sa është numri i punonjësve që ka aktualisht Hekurudha Shqiptare?

Aktualisht Struktura Organizative e “Hekurudha Shqiptare” sha, ka në përbërje të saj 550 punojës. Për më shumë informacion mbi mënyrën organizative ju lutem të aksesoni faqen web [www.hekurudha.al](https://hekurudha.al/organigrama/) (<https://hekurudha.al/organigrama/>).

2-Sa është fondi i pagave për punonjësit? Sa është paga mesatare në Hekurudhën Shqiptare?

Fonti i pagave për periudhën janar- mars 2024 është 80,907,000.00 lekë, dhe paga mesatare referuar të njëjtës periudhë përllogaritet në vlerën e 46 022 (dyzet e gjashtë mijë e njëzet e dy) lekë.

3-Në faqen e Hekurudhës, shpesh hapen thirrje për vendet vakante, cilat janë pozicionet pa staf aktualisht?

Sikudër parashtraum në përgjigjen e pyeties së parë, “Hekurudha Shqiptare” sha, ka në strukturën e saj organizative 550 punojës. Në varësis të rrethanave objektive (dalja në pension, dorëheqje nga vëndi i punës etj) vëndet që shndërrohen vakante, nxinin nisjen e procedurës së rekrutimit, duke përfshirë në këtë pikë thirrjet për vëndet vakante. Për vëndet aktuale vakante, mund të aksesoni faqen web www.hekurudha.al.

4-Sa trena ka Shqipëria dhe sa prej tyre janë funksional? Bilanc për 5 vitet e fundit?

Në fund të vitit 2023 Hekurudha Shqiptare ka 18 lokomotiva, 114 vagona mallrash dhe 18 vagona pasagjerësh.

Aktalisht lëvizin 3 herë në javë 3 trena pasagjerësh nga Elbasani-Plazh dhe anasjelltas në ditët e premte, e shtunë dhe e diel si dhe 2 trena Shkodër – Laç dhe anasjelltas në ditët e marta vetëm për periudhën e Kishës së Laçit Mars-Qershor.

Për sa i përket transportit të mallrave për shkak të rinovimit të linjës hekurudhore për tre mujin e parë të vitit 2024 janë realizuar rreth 15 trena me materiale që janë në funksion të rinovimit të linjës Durrës-Tiranë.

5- Sa është numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me tren në 5 vitet e fundit? Sa është volumi i mallrave të transportuara për këtë periudhë?

	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	3-Mujori I 2024
Udhëtarë të transportuar	59 800	17 950	24 020	10 604	7 360	873
Mallra të transportuara në ton	107 030	75 200	75 250	3 673	1 020	1 841

6-Në kushtet kur aktiviteti i hekurudhave është i ulët në Shqipëri, për shkak edhe të rehabilitimit të pjesës më të madhe të rrjetit hekurudhor në vend, a nuk është i lartë numri i punonjësve që ka hekurudha? (në nëntor 2023 sipas shifrave kishit mbi 600 punonjës)

“Hekurudha Shqiptare” shpall në strukturën e saj organizative 550 punonjës, të cilët referuar nevojave që ka kjo Shoqëri ushtrojnë detyrat e tyre funksionale. Ky numër punëmarrësisht ka një historik që tregon një grafik në rënie, kjo si rrjedhojë dhe e implementimeve të projekteve rehabilituese të cilat po jetësohen në linja të caktuara në rrjetin hekurudhor shqiptar, me qëllim final vitalizimin e tij sipas të gjitha standarteve europiane infrastrukturore.

7-Pra cili është funksioni i punonjësve, në kushtet kur aktiviteti është i ulët?

Të punësuarit në Shoqëri ushtrojnë detyrat e tyre funksionale në propocion me Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Shoqërisë. Në varësi të pozicionit të punës, në këtë rregullore parashihen detyrat përkatëse. Në vijim të interesit tuaj mbi funksionin e punonjësve ju lutem të aksesoni linkun <https://hekurudha.al/baza-ligjore/>. Në kushtet ku trafiku hekurudhor ka pësuar rënie, vlen të theksojmë se janë ndërmarr masa që përshtasin numrin e fuqisë punëtare me nevojat që ka kjo Shoqëri.

8-Sa janë të ardhurat e arkëtuara nga Hekurudha Shqiptare në 5 vitet e fundit?

Informacioni mund të gjendet lehtësisht tek pasqyrat financiare të publikuara (në faqen web dhe në QKB). Megjithatë po ju bashkëlidhim informacionin e kërkuar. Lutemi të konsideroni se puna kërkimore, kur informacioni është i publikuar, nuk është përgjegjësi e autoritetit publik.

TE ARDHURA, VITI 2023			
VITI	TIPOLOGJIA	EMERTIMI	VLERA (Leke)
2023	Aktivitet kryesor	Te ardhura transport Malli	529,936
2023	Aktivitet kryesor	Te ardhura transport Udhetar	906,745
2023	Aktivitet dytesor	Shitje mallra (skrap hekurudhor)	34,938,917
2023	Aktivitet dytesor	Te ardhura nga qerate	7,952,876
2023	Ndihme shteterore	Subvencion per Hekurudhen Shqiptare nga buxheti i shtetit	490,000,000
2023	Te ardhura te tjera	Te ardhura nga materjalet e investimeve dhe kuot pjese	131,133,754
2023	Te ardhura te tjera	Te ardhura te tjera	34,408,828
2023	Te ardhura te tjera	Te ardhura nga kursi i kembimit te detyrimeve ne monedhe te huaj	344,539,654
		Te ardhura total	1,044,410,710

TE ARDHURA, VITI 2022			
VITI	TIPOLOGJIA	EMERTIMI	VLERA (Leke)
2022	Aktivitet kryesor	Te ardhura transport Malli	2,367,500
2022	Aktivitet kryesor	Te ardhura transport Udhetar	1,129,708
2022	Aktivitet dytesor	Shitje mallra (skrap hekurudhor)	-
2022	Aktivitet dytesor	Te ardhura nga qerate	3,529,160
2022	Ndihme shteterore	Subvencion per Hekurudhen Shqiptare nga buxheti i shtetit	501,000,000
2022	Te ardhura te tjera	Te ardhura nga materjalet e investimeve dhe kuot pjese	57,983,523
2022	Te ardhura te tjera	Te ardhura te tjera	191,480,360
2022	Te ardhura te tjera	Te ardhura nga kursi i kembimit te detyrimeve ne monedhe te huaj	39,277,152
		Te ardhura total	796,767,403

Shenim: Bejme me dije se te ardhurat nga ndihma shteterore jane perdorur kryesisht per përballimin e pagesave për paga dhe detyrime fiskale.

TE ARDHURA, VITI 2021			
VITI	TIPOLOGJIA	EMERTIMI	VLERA (Leke)
2021	Aktivitet kryesor	Te ardhura transport Malli	56,562,741
2021	Aktivitet kryesor	Te ardhura transport Udhetar	1,148,829
2021	Aktivitet dytesor	Shitje mallra (skrap hekurudhor)	13,216,902
2021	Aktivitet dytesor	Te ardhura nga qerate	2,910,471
2021	Ndihme shteterore	Subvencion per Hekurudhen Shqiptare nga buxheti i shtetit	400,000,000
2021	Te ardhura te tjera	Te ardhura nga materjalet e investimeve dhe kuot pjese	57,378,974
2021	Te ardhura te tjera	Te ardhura te tjera	55,437,494
2021	Te ardhura te tjera	Te ardhura nga kursi i kembimit te detyrimeve ne monedhe te huaj	-
		Te ardhura total	586,655,411

Shenim: Bëjme me dije se të ardhurat nga ndihma shtetërore janë përdorur kryesisht për përballimin e pagesave për paga dhe detyrime fiskale.

TE ARDHURA, VITI 2020			
VITI	TIPOLOGJIA	EMERTIMI	VLERA (Leke)
2020	Aktivitet kryesor	Te ardhura transport Malli	,541,661
2020	Aktivitet kryesor	Te ardhura transport Udhetar	838,425
2020	Aktivitet dytesor	Shitje mallra (skrap hekurudhor)	28,537,794
2020	Aktivitet dytesor	Te ardhura nga qerate	2,341,113
2020	Ndihme shteterore	Subvencion per Hekurudhen Shqiptare nga buxheti i shtetit	400,000,000
2020	Te ardhura te tjera	Te ardhura nga materjalet e investimeve dhe kuot pjese	60,129,690
2020	Te ardhura te tjera	Te ardhura te tjera	14,637,983
2020	Te ardhura te tjera	Te ardhura nga kursi i kembimit te detyrimeve ne monedhe te huaj	74,347,671
		Te ardhura total	632,374,337

Shenim: Bëjme me dije se të ardhurat nga ndihma shtetërore janë përdorur kryesisht për përballimin e pagesave për paga dhe detyrime fiskale.

TE ARDHURA, VITI 2019			
VITI	TIPOLOGJIA	EMERTIMI	VLERA (Leke)
2019	Aktivitet kryesor	Te ardhura transport Malli	112,912,665
2019	Aktivitet kryesor	Te ardhura transport Udhetar	2,921,226
2019	Aktivitet dytesor	Shitje mallra (skrap hekurudhor)	36,324,589
2019	Aktivitet dytesor	Te ardhura nga qerate	4,025,728
2019	Ndihme shtetërore	Subvencion per Hekurudhen Shqiptare nga buxheti i shtetit	400,000,000
2019	Te ardhura te tjera	Te ardhura nga materialet e investimeve dhe kuot pjese	73,778,489
2019	Te ardhura te tjera	Te ardhura te tjera	32,264,645
2019	Te ardhura te tjera	Te ardhura nga kursi i kembimit te detyrimeve ne monedhe te huaj	8,238,461
		Te ardhura total	670,465,803

Shenim: Bëjme me dije se të ardhurat nga ndihma shtetërore janë përdorur kryesisht për përballimin e pagesave për paga dhe detyrime fiskale.

9-Cilat janë burimet nga të cilat janë mbledhur të ardhurat?

Përgjigja e kësaj pyetje gjendet në tabelat e bashkëlidhura me sipër (përgjigja e pyetjes nr. 8)

10- Sa të ardhura ka përfituar hekurudha nga buxheti i shtetit në 5 vitet e fundit, dhe për çfarë janë përdorur?

Përgjigja e kësaj pyetje gjendet në tabelat e bashkëlidhura me sipër (përgjigja e pyetjes nr. 8)

11- Sa milionë euro po investohen aktualisht në projektet hekurudhore në vend, dhe kur pritet të përfundojnë ato për tu bërë funksionale?

Në lidhje me investimet në rrjetin hekurudhor shqiptar, sqarojmë për si vijon:

- Projekti “Durrës – Tirana PTT – Aeroporti i Rinasit”: 36.65M Euro (Grant nga BE) + 36.87M Euro (kredi nga BERZH) + 29M Euro (shtesë kredie nga BERZH) – perfundimi: Shkurt 2025

- Godinat e stacioneve per “Durrës – Tirana PTT – Aeroporti i Rinasit”: 10.5M Euro (kredi nga BERZH) përfundimi: Qershor 2025
- Projekti “Vorë – Hani i Hotit”: 133M Euro (Grant nga BE) + 98.75M Euro (kredi nga BERZH) + 100M Euro (kredi nga BEI) – përfundimi: Maj2030

**Autoriteti publik “Hekurudha Shqiptare” Sh.A, angazhohet në garantimin e të drejtës së informimit, si garanci kushetuese dhe vepron në mbështetje të ligjit Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të Drejtën e informimit” dhe trajton kërkesën tuaj në përputhje me Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Me konsideratë!

KOORDINATORI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT

Domeniko SINJARI